

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

PLANI STRATEGJIK 2020- 2024

Gjithçka që FSHN do të bëjë gjatë periudhës 2020-2024 është se do të përqendrohet në forcimin e 4 shtyllave të mëposhtme.

Plani ynë Strategjik përcakton 10 synime për të cilat FSHN do të punojë për të arritur gjatë 4 viteve të ardhshme.

Ne shpresojmë të punojmë me të gjithë partnerët dhe palët e interesit në vitet e ardhshme për të arritur këto qëllime dhe për të rritur familjen tonë të sporteve ujore.

SHTYLLAT KRYESORE

1. Rritja e standardeve të zhvillimit të sportit të notit
2. Nxitja e potencialeve
3. Bashkimi i Pasioneve
4. Rritje e qëndrueshme

VIZIONI:

Cdo njeri të mund të notoje.

MISIONI:

Te shtohen disiplinat e ujit, si waterpolo dhe Diving, duke bërë e mundur shtimin e numrit të personave që ushtrojnë disiplinat e ujit.

4 SHTYLLAT E PLANIT STRATEGJIK

- a) Rritja e standardeve të zhvillimit të sportit të notit, arrihet nepermjet përmirësimeve të vazhdueshme të administrimit dhe të drejtimit të sporteve të ujit, në shërbim të shëndetit dhe mirëqenies së sportistëve.
- b) Nxitja e potencialeve zhvillon strukturën për mbështetjen e shoqatave dhe klubeve, anetare të FSHN-se, në mënyrë që të rrisin pjesëmarrjen dhe performancën e tyre për të konkuruar sa më denjësisht në arenën nderkombetare.
- c) Duke bashkuar pasionet, punohet për partneritet ndërmjet sportistëve dhe ekipeve, që të angazhohen për të rritur audiencën dhe interesin në çdo skaj të vendit për sportet e ujit.

- d) Rritja e qendrueshme, synon ne organizmin e aktiviteteve argetuese,duke bashkepunuar me partnere te medhenj per te rritur te ardhurat dhe per ti riinvestuar ne sported e ujit.

FSHN do te mbeshtetet ne keto kater shtylla duke pasur si foKus arritjen e 10 qellimeve strategjike.

QELLIMET STRATEGJIKE:

1. Optimizimi i organizimit dhe efektshmerise

Që sportet e ujit të lulëzojnë në të gjithë vendin, FSHN dhe gjithë strukturat e saj duhet të veprojnë si një makineri me performancë të lartë. FSHN duhet të shfrytëzojë talentin, njohuritë dhe teknologjinë për të rritur standardet, për të përmirësuar efektivitetin dhe për të dhënë rezultate në nivele të larta shërbimi për anëtarët e saj dhe komunitetin e sporteve të ujit.

2. Zbatimi i nje qeverisje te mirë ne te gjitha strukturat e FSHN-se dhe te paleve te interesit.

FSHN pranon që një kulturë e qeverisjes së mirë duhet të përshkojë çdo aspekt të sporteve ujore. FSHN do të shqyrtoje rregullisht dhe do të identifikojë mënyrat për të përmirësuar qeverisjen e vet dhe për të ndihmuar anetaret e saj (shoqatat dhe klubet) të miratojnë dhe zbatojne parimet e qeverisjes së mirë.

3. Sigurimi i mirëqenies e sportistevë dhe te sportit tone.

Thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e sporteve ujore është shëndeti dhe mirëqenia e sportistevë. FSHN do të vazhdojë të punojnë në mbështetje të sportistevë, duke siguruar udhëzime dhe një kornizë rregullatore në mënyrë që ata të qëndrojnë të shëndetshëm dhe te mund të konkurrojnë me moton se të gjithë kanë një shans të drejtë dhe të barabartë të suksesit.

4. Rritja e pjesemarrjes ne sportet e ujit.

Ndërtimi i bazave të forta është një kërkesë për rritjen dhe zhvillimin e sporteve ujore. FSHN duhet te aplikoje programe qe do të sigurojnë burime për të ndihmuar më shumë njerëz qe të

përrjetojnë kënaqësinë e sportit të notit dhe përfitimet e tij, duke iniciuar rrugetimin e talentëve edhe në arenën ndërkombëtare.

5. Motivimi për një performancë sa më të lartë.

Rritja e numrit të anëtarëve të FSHN-së, me shoqatave dhe klube, do të stimulojnë pjesëmarrjen më të madhe në sportin e notit. FSHN do të vazhdojë të zhvillojë platformën që ndihmon të talentuarit, duke bërë të mundur që ato të kuptojnë potencialin e tyre dhe të garojnë në nivelin më të lartë.

6. Angazhimi dhe rritja e audiencës në mbare vendin.

Frymëzimi i adhuruesve të sportit të notit nga performancat dhe arritjet e idhujve të tyre në sportin e notit. FSHN do të publikojë ngjarje emocionale rreth sportistëve tanë, ekipeve tona dhe aktiviteteve tona, për të nxitur pasionet dhe për të frymëzuar sa më shumë njerëz në të gjithë vendin, që ato të angazhohen dhe të ndjekin sportin e notit.

7. Frymëzimi i sportistëve që ato të jenë me të mirë nga çmimet që jehen.

Krijimi i mjediseve stërvitore të specializuara, në të cilat sportistët zhvillojnë talentin dhe pasionin e tyre për sportin e notit është jetike. FSHN do të mundësojë sportistëve përvojën të shkëlqyerë konkurruese në eventet ndërkombëtare, duke i motivuar ato më shumë për të garuar me performancë gjithnjë e më të lartë.

8. Organizimi në mënyrë të vazhdueshme i aktiviteteve argetuese.

Duke tërhequr vëmendjen e audiencës në mbare vendin, aktivitetet e FSHN-së do të krijojnë argëtim unik dhe të vlefshëm për të tërhequr dhe rritur audiencën për sportin e notit.

9. Bashkëpunimi i paleve të interesuara për promovimin sa më të mirë të sporteve të ujit.

Duke promovuar sportin e notit në të gjithë vendin, FSHN do të mbajë dhe do të rrisë marrëdhëniet ndërmjet sportit, qeverisë dhe ndërmarrjeve të industrisë në një nivel kombëtar dhe lokal.

10. Maksimizimi I te ardhurave per nje rritje te qendrueshme te sporteve te ujit.

Rritja e të ardhurave nga garat elitare të FSHN-se është thelbësore për të mbështetur rritjen e sportit tonë.

Strategjia tregtare e FSHN-se do të inkurajojë investimet në sportet ujore, do të krijojë partneritete të vlefshme, dhe do të gjenerojë të ardhura për të riinvestuar në pjesëmarrjen dhe programet me performancë të lartë.